



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 29 dhjetor 2021 dhe vazhduar më 30 dhjetor 2021, në mbledhjen e III-të (tretë), të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.

Mbledhja filloi në orën 10:30 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, në ndërtesën e re të Komunës së Podujevës.

Mbledhjen e kryesoi z.Hilmi Hoxha, *(anëtari më i moshuar me radhë i Kuvendit të Komunës)* *(pasi që z.Fahri Hasani si anëtari më i moshuar i zgjedhur/certifikuar dhe emëruar nga KQZ, nuk pranoi ta bëjë kryesimin e mbledhjes, me arsyetimin se nuk është në gjendje të mirë shëndetësore për një gjë të tillë)*, si dhe një pjesë të mbledhjes e kryesoi z.Naim Çunaku *(në cilësinë e anëtarit më të moshuar prezent në mbledhje)*

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç znj.Arjeta Abazi e cila aktualisht nuk ishte prezent dhe z.Bashkim Sylja i cili mungoi.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale dhe më gjerë, përfaqësues të KFOR, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tera theksoi, të nderuar këshilltarë/e, zotëri Kryetar i Komunës, zonja dhe zotërinj, e hapi mbledhjen e tretë të kësaj legjislature të Kuvendit të Komunës e cila është thirr mbledhje e rregullt. Fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse, konstatoj se 33 anëtar/e janë prezent, ndërsa mungojnë 2, pra kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë.

Sa për rikujtim, deri në zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, mbledhjet e Kuvendit të Komunës thirren dhe kryesohen nga anëtarit më i moshuar i Kuvendit, andaj mbi këtë rregull është thirr kjo mbledhje me pikat përkatëse të rendit të ditës që është zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit dhe Komiteti për Politikë dhe Financa.

Para se të fillojmë me punë, jam i njoftuar se prezent janë edhe 2 anëtarë të Kuvendit të cilët janë zëvendësuar nga KQZ dhe tani vetëm duhet që të bëhet verifikimi i mandatit të tyre dhe dhënia e betimit, fjala është për Fahri Hasani i cili zëvendëson Ekrem Hysenin, dhe Mimoza Abdullahu e cila zëvendëson Floretë Zejnullahun, mirëpo edhe pse pothuajse njihemi mes vete, kërkohet që nëse ndonjëri prej tyre është më i moshuar se unë, të deklarohet në mënyrë që t'i kalon e drejta për ta kryesuar mbledhjen. Pra nëse prej këtyre dy anëtarëve të ri të Kuvendit, meqë tjerët janë të gjithë më të ri se unë, por z.Fahri Hasani i cili ka dal në pension tani së fundmi dhe besoj se është më i moshuar se unë duhet të deklarohet për ta marrë kryesimin e mbledhjes.

z.Fahri Hasani, përshëndeti të pranishmit, theksoi, meqë nuk jam mirë me shëndet dhe nuk e di se a mund të qëndroj gjatë në seancë, kësaj radhe nuk jam i interesuar dhe nuk mundem ta udhëheqë mbledhjes.

Kryesuesi i mbledhjes z.Hilmi Hoxha, vazhdoi, meqë parafolësi z.Fahri Hasani deklaroi se nuk është i interesuar ta marrë kryesimin e kësaj mbledhje, atëherë konstatojmë se mund ta vazhdojmë mbledhjen.

Tani para se anëtarët e cekur të japin betimin, ftoj Komisionin për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit, znj.Donjetë Sheqiri, znj.Sebastina Vokrri, znj.Endritë Murati, të verifikoj mandatin e të përmendurve, dhe të paraqet raportin përkatës.

Nga ana e Komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit, bëhet verifikimi i mandatit të z.Fahri Hasani dhe znj.Mimoza Abdullahu

znj.Sebastina Vokrri, në emër të Komisioni përkatës paraqiti raportin, theksoi, në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 të Ligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-072, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është marrë vendim sipas të cilit znj.Mimoza Abdullahu emërohet anëtare e Kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës duke zëvendësuar znj.Floretë Zejnullahu, po ashtu në bazë të vendimit tjetër përkatës, z.Fahri Hasani emërohet anëtar i Kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke zëvendësuar z.Ekrem Hysenin.

Atëherë Komisioni konstaton se çdo gjë është në rregull dhe mund të vazhdohet me dhënien e betimit solemn dhe procedurat tjera përkatëse.

Kryesuesi i mbledhjes z.Hilmi Hoxha, vazhdoi, në bazë të raportit të Komisionit përkatës u konstatua se çdo gjë është në rregull dhe mund të vazhdohet tutje.

Tani ftoj z.Fahri Hasanin dhe znj.Mimoza Abdullahun të ngritën në këmbë për dhënien e betimit. Unë e lexoj me zë kurse përsëritet nga Ju, me të vetmin plotësim që pas fjalës UNË, ju e përmendni emrin e juaj, kurse tekstin tjetër e përsëritni pjesë pjesë.

Me tekstin në vijim:

“Unë, (duke e përmendur secili emrin dhe mbiemrin e tij) betohem se do t’i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

z.Fahri Hasani dhe znj.Mimoza Abdullahu, japin betimin dhe nënshkruajnë deklaratën e betimit

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, urime të nderuar tani edhe zyrtarisht jeni këshilltar/e në Kuvendin e Komunës së Podujevës.

Tani vazhdojmë, thirrja e kësaj mbledhje së bashku me materialin përkatës u është dërguar me kohë, andaj ju lutem a pajtoheni të vazhdojmë me punë.

Konstatohet se njëzëri nga të pranishmit u miratua rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:

- 03 dhjetor 2021 - mbledhja inauguruese
- 17 dhjetor 2021 - mbledhja e jashtëzakonshme

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, në vazhdim kemi procesverbalet nga dy mbledhjet paraprake, urdhëroni nëse ndokush ka ndonjë vërejtje, plotësim apo ndryshim eventual.

z.Florent Hasani, theksoi, ka qenë një gabim teknik ku në procesverbalin e mbledhjes inauguruese, përkatësisht tek pjesa ku është dhënë betimi, gjithë këshilltarëve të Kuvendit ju është shkruar “nga subjekti politikë LDK”, mirëpo meqë është përmirësuar dhe është dërguar përmes e-maili procesverbali i korrigjuar, ne tani nuk kemi diçka tjetër dhe e votojmë këtë.

Kryesuesi i mbledhjes, e kam vërejtur atë gabim i cili ju është përvjedhur zyrtarit përkatës dhe natyrisht se është gabim teknik, por meqë është korrigjuar menjëherë të nesërmen besoj se tani jemi në rregull, andaj urdhërorin nëse ndokush ka diçka për të shtuar, nëse jo i hedh në votim procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri, pa plotësim ndryshime, u miratuan procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më 03.12.2021 – mbledhja inauguruese, dhe 17.12.2021 mbledhje e jashtëzakonshme.

2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës

- Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit
- Propozimi i kandidatëve
- Procesi i votimit
- Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, në radhë kemi pikën e rendit të ditës që është zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, sikurse e kemi sqaruar në mbledhjen e kaluar dhe siç edhe keni parë në thirrjen e kësaj mbledhje parashihen edhe disa nënpika procedurale, fillimisht kemi si nënpikë;

- **Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit**

Në bazë të nenit 2.3 të UA nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësit e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, parashihet që Komisioni në fjalë të përbëhet 3 deri 5 anëtar të Kuvendit, i cili është përgjegjës që të numëroj votat dhe t’i komunikoj rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, dhe çështje tjera procedurale në këtë proces, andaj urdhëroni nëse ndokush ka ndonjë propozim rreth formimit të këtij Komisioni, apo të shkojmë sipas renditjes së subjekteve të Kuvendit, qoftë me 3 apo 5 anëtar, pra a ka ndonjë propozim rreth numrit të anëtarëve në këtë komision.

Meqë nuk ka propozime për përbërën e këtij komisioni, atëherë unë propozoj që ky Komision të përbëhet prej 3 anëtarëve dhe atë nga tri subjektet politike me numrin më të madh të përfaqësimit në Kuvend.

Pas votimit u konstatua se, me 32 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë E PËRMBAJTUR dhe një anëtar nuk mori pjesë në votim, miratohet propozimi që Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit të ngritet në përbërje prej 3 anëtarëve dhe atë nga tri subjektet me numrin më të madh të përfaqësimit në Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit, ftoj përfaqësuesit e subjekteve LDK, LVV dhe PDK që sipas radhës të propozojnë anëtarët për këtë Komision.

z.Valon Demolli, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, ashtu siç e kemi cekur edhe në seancën e kaluar nuk do të marrim pjesë në këtë proces. Ne mendojmë se barra për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit i takon partisë fituese, prandaj ne nuk do të jemi pjesë e procesit.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, e propozon z.Bahri Selimin për anëtar të Komisionit në fjalë.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, e propozojmë znj.Endritë Muratin për anëtare të Komisionit në fjalë.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, meqë Grupi i LDK-së refuzoj të propozoj anëtarin e tyre për Komisionin në fjalë, tani në radhë është subjekti AAK i cili mund ta propozoj një anëtar.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të AAK-së propozohet z.Arbnor Fazliu.

Kryesuesi i mbledhjes z.Hilmi Hoxha, theksoi, pra kemi tri propozime për anëtar në Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit, dhe atë; nga LVV z.Bahri Selimi, nga PDK znj.Endritë Murati dhe nga AAK z.Arbnor Fazliu, andaj e hedh në votim.

Pas votimit Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se me 20 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë TË PËRMBAJTUR, të tjerët nuk morën pjesë në votim, miratohet propozimi që të ngritët Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit në këtë përbërje;

z.Bahri Selimi

z.Endritë Murati

z.Arbnor Fazliu

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të LVV-së kërkojmë një pauzë prej 30 minutave.

Kryesuesi i mbledhjes, e hedh në votim propozimin e parafolësit.

Pas votimit, Kryesuesi i mbledhjes, konstatoi se me 17 vota PËR, 15 vota KUNDËR dhe 1 votë TË PËRMBAJTUR, mbështete propozimi për pauzë prej 30 minutave, dhe njëkohësisht Kuvendi shkon në pauzë në ora 10;55

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 11;50

Fillimisht Kryesuesi i mbledhjes konstaton se aktualisht prezent në sallë janë 32 anëtar/e të Kuvendit (përfshirë edhe znj.Arjeta Abazi e cila në fillim të mbledhjes nuk ishte prezente), kështu që kuorumi ekziston dhe mund të vazhdohet me punë.

znj.Endritë Murati, theksoi, Partia Demokratike e Kosovës propozon që seanca të shtyhet për një kohë të pacaktuar për shkak të mungesës së një anëtari të Kuvendit nga radhët e PDK-së i cili ka rast të vdekjes në familje, andaj edhe ne kemi vendosur që të marrim pjesë në varrim.

z.Naim Çunaku, theksoi, propozimi i parafolëses edhe mund të jetë ashtu, por jo në kohë të pacaktuar kur mund ta caktojmë kohën e vazhdimit të seancës.

z.Gazmend Islami, theksoi, fillimisht e mbështes propozimin për shtyrjen e seancës sepse edhe ne e kemi mik dhe koleg anëtarin në fjalë, mirëpo paraprakisht do të doja të bëjë një thirrje prej qytetarëve për lojërat politike që po i bëjnë subjektet e mëdha që janë në këtë Kuvend, pra bëjë thirrje që të mos luhet në këtë formë sepse është e pamoralshme, e pandershme, jonjerëzore me këtë lojë që janë duke e bërë dy subjektet më të mëdha në këtë Kuvend.

Pra të vazhdohet me lojëra të tilla para qytetarëve por të zgjedhet Kryesuesi i Kuvendit dhe të ecim përpara sepse këtë e kemi obligim dhe detyrë sepse qytetarët na kanë zgjedhur për ta zgjedhë kryesuesin dhe për punë të tjera, jo për lojëra të tilla ngase sikurse LDK ashtu edhe LVV duhet t'i shtyjnë proceset përpara.

Po ashtu edhe Kryetari i Komunës si fitues i zgjedhjeve i cili po del me deklarata për çdo ditë duke thënë (i'u heqa maskat opozitës), do të ishte mirë t'ia (heqë maskën së pari vetës) dhe të del para qytetarëve si fitues i zgjedhjeve dhe të qon përpara procesin për zgjedhjen e Kryesuesit, dhe të lihen këto lojëra (jo sot, jo nesër, jo ju dërgoj në zgjedhje jo nuk ju dërgoj), lojëra të cilat unë i konsideroj si lojëra fëmijësh. Prandaj unë ju bëjë thirrje së pari LDK-së që nëse kanë propozim për Kryesues të Kuvendit ta bëjnë një gjë të tillë dhe të ecim përpara, sikurse që edhe LVV-ës i'a bëjë të njëjtën thirrje sepse nuk kemi kohë për humbur, përndryshe nëse jeni të interesuar për zgjedhje urdhëroni shkoni në zgjedhje, bëni hajgare, para keni, pushtetin e keni kapë.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kërkon që seanca të vazhdoj.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim propozimin e znj.Endritë Murati që kjo seancë të ndërpritet sot për të vazhduar ditën e nesërme në të njëjtën kohë (nga ora 10;00).

Pas votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se meqë 4 vota janë PËR, 13 vota KUNDËR dhe 11 vota TË PËRMBAJTURA, nuk përkrahet propozimi i znj.Endritë Murati për ndërprerjen e kësaj seance për të vazhduar nesër në të njëjtën kohë (nga ora 10;00)

Kryesuesi i mbledhjes, shtoi, unë sërish e kam një propozim që ne për shkak të vdekjes së Babait të kolegut këshilltar i Kuvendit z.Bashkim Syla, patjetër duhet të marrim pjesë në varrim, andaj nuk e di përse nuk po tregohet paksa mirëkuptim nga ana juaj që të jemi pjesëmarrës në varrimin e Babait të Bashkim Sylës.

z.Gazmend Islami, theksoi, nëse jemi dakord ne mund të shkojmë në varrim të Babait të kolegut në fjalë, dhe pas varrimit mund të kthehemi ta vazhdojmë seancën, ndoshta nga ora 15;00, andaj nuk besoj se do të kishte ndonjë pengesë.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, nëse jeni të pajtimit ne mund ta hedhim sërish propozimin po thuajse të ngjashëm që e japi z.Gazmend Islamit që të shkohet në pauzë, por që të kthehemi pas varrimit të Babit të këshilltarit z.Bashkim Syla, në ora 15;00

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, sa i për kësaj çështje veç u votua njëherë dhe si temë tani më mund të konsiderohet e ezauruar, mendoj se nuk mund të ketë sërish votim për diçka që i'u nënshtrua votimit paraprakisht, andaj mbetet të vazhdohet me seancën.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, atëherë vazhdojmë me seancën sipas rendit të ditës, ju përkujtoj se propozimet e kandidatëve për kryesues të Kuvendit mund t'i bëjnë: -Subjektet politike në kuadër të përbërjes së Kuvendit, -Nismë qytetarësh, apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në Kuvend, -Ndonjë Grup i këshilltarëve apo një këshilltar.

Parimisht është mirë që për çdo propozim të kandidatit, të prezantohet biografi e shkurtër nga ana e propozuesit. Andaj ju lutem radha është të paraqiten propozimet e juaja për kandidat për Kryesues të Kuvendit, urdhëroni;

Këshilltarët e Grupit të PDK-së, znj.Endritë Murati dhe znj.Mimoza Abdullahu, lëshuan seancën.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së propozon për Kryesues të Kuvendit të Komunës zonjën e cila për herë të tretë radhazi ka fituar besimin e qytetarëve për përfaqësim në Kuvend, profesioniste shëndetësore për 19 vite, menaxhere dhe ai person është zonja Adelinë Stublla.

Kryesuesi i mbledhjes z.Hilmi Hoxha, theksoi, a ka ndonjë propozim tjetër për kandidat/e për Kryesues/e të Kuvendit të Komunës, urdhëroni, nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së a ka ndonjë qëndrim.

z.Valon Demolli, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së e kemi shprehur qëndrimin tonë edhe më herët se nuk kemi kandidat/e për Kryesues/e të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, meqë nuk ka propozime tjera për kandidat/e për Kryesues/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës në këtë mandat, konstatojmë se në bazë të propozimeve të paraqitura kandidate për Kryesues të Kuvendit të Komunës është vetëm znj.Adelinë Stublla nga radhët e subjektit LVV.

Sa për rikujtim dhe sqarim, legjislacioni në fuqi parasheh që votimi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit bëhet me vota të fshehta dhe ekzistojnë tri raunde për zgjedhjen e Kryesuesit, si në vijim;

1-Për tu zgjedhur në votimin e parë kandidati i propozuar për Kryesues të Kuvendit të Komunës duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

2-Nëse pas votimit të parë asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryesues të Kuvendit të Komunës nuk merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, atëherë dy kandidatët të cilët kanë fituar numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në raundin e dytë zgjedhët Kryesues i Kuvendit të komunës

3-Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk fiton shumicën e kërkuar si në pikën paraprake, atëherë shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë Kryesues i Kuvendit të Komunës zgjedhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës

Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës përsëritet.

Pra kjo ishte vetëm sa për sqarim dhe rikujtim dhe besoj se tani jemi në rregull.

E ftoj Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit që në bashkëpunim me zyrën për punë të Kuvendit të përgatitin fletëvotimet me emra dhe mbiemra të kandidatëve, *(në këtë rast meqë kemi vetëm një kandidate, fletëvotimet përgatitet vetëm për kandidaten në fjalë)* në mënyrë që të fillohet me procesin e votimit të fshehtë sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu meqë u vendos që të vazhdohet me seancën dhe nuk kaloj propozimi i znj.Endritë Murati për ndërprerje të seancës për të vazhduar nesër, dy këshilltarët e Grupit të PDK-së kanë lëshuar seancën, mirëpo ajo që vlen të theksohet është se znj.Endritë Murati ishte pjesë e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit i cili u formua në fillim të kësaj mbledhje, dhe tani nuk është prezentë, andaj konsideroj se Komisioni duhet të plotësohet me një anëtar/e në mënyrë që të vazhdohet me procesin e votimit për Kryesues të Kuvendit të Komunës. Urdhëroni mund të jepen propozimet për anëtar/e të Komisionit në fjalë, mirëpo duke pas parasysh që LVV, AAK i kanë anëtarët e tyre në Komision, Grupi i PDK-së përveç meje e kanë lëshuar seancën, Grupi i LDK-së është deklaruar që nuk merr pjesë në këtë proces mirëpo nëse dëshiron mund ta propozoj tani një anëtar/e në Komisionin e cekur, nëse jo atëherë shkojmë me

z.Gazmend Islamin nga radhët e subjektit OBKD të cilin paraprakisht e pyesim se a dëshiron të jetë pjesë e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit në vend të anëtares që ishte znj.Endritë Murati. (Deklarimi i z.Gazmend Islami ishte që po nuk paraqet ndonjë problem që të jetë pjesë e Komisionit në fjalë).

Pas votimit Kryesuesi konstatoi se nga 30 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 17 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë TË PËRMBAJTUR, të tjerët nuk morën pjesë në votim, miratohet propozimi që z.Gazmend Islami të jetë anëtar i Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, përkatësisht përbërja e Komisionit në fjalë formohet si në vijim;

z.Bahri Selimi

z.Arbnor Fazliu

z.Gazmend Islami

Kryesuesi i mbledhjes, vazhdoi, konsideroj se tani jemi në rregull dhe mund të vazhdojmë me punë, përkatësisht me përgatitjen e dokumenteve/fletëvotimeve dhe çështjeve tjera përkatëse, urdhëroni zyra përkatëse për punë të Kuvendit mund t'i përgatitni, kurse deri në përgatitjen e materialit të cekur, propozoj të kemi pauzë të shkurtër prej 10 minuta, brenda ndërtesës së Komunës, pastaj fillojmë me procesin e votimit.

Para se të kthehemi nga pauza, ju njoftoj se për arsyet që i patëm më herët ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, unë nuk mund ta vazhdoj me seancën dhe njëkohësisht me kryesimin e seancës, andaj thërras anëtarin më të moshuar me radhë që ta merr kryesimin e kësaj seance, siç po vërehet z.Naim Çunaku është anëtari më i moshuar në radhë dhe ftoj ta merr kryesimin e seancës, por kjo çështje të verifikohet edhe njëherë.

Pauzë e shkurtër brenda sallës apo eventualisht brenda ndërtesës së Komunës, deri sa të përgatiten materialet për raundin e parë të votimit për Kryesuese të Kuvendit të Komunës

Pas verifikimit të moshës.

Kryesimi i mbledhjes i kalon anëtarit më të moshuar në radhë z.Naim Çunaku.

z.Naim Çunaku, Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, të nderuar anëtar dhe anëtare të Kuvendit, tani mund të fillohet me procedurat për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit. Momentalisht prezent në sallë për të filluar këtë proces janë 30 anëtar/e të Kuvendit, të cilët edhe mund të konsiderohen si pjesëmarrës të konfirmuar për procesin e votimit.

Lus Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit që të thërrasin emër për emër të gjithë anëtarët e Kuvendit duke i thirrur për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar, qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim, si dhe çështjet tjera procedurale.

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, theksoi, si komision konstatojmë se për këtë raund të votimit, lista e anëtarëve të Kuvendit është në rregull, fletëvotime po ashtu janë 35 dhe të gjitha të rregullta, vulën po ashtu e posedojmë dhe do të vulosen fletëvotimet e të gjithë anëtarët të cilët nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në procesin e votimit ku me ç'rast edhe marrin fletëvotimin. Pra mund të fillojmë duke i thirrur emër për emër me radhë sipas listës përkatëse.

Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit (në përbërje z.Bahri Selimi, z.Arbnor Fazliu dhe z.Gazmend Islami) fillon punën duke verifikuar fletëvotimet fillimisht, listën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pastaj duke thirrur emër për emër sipas radhës gjithë anëtarët e Kuvendit të cilët sipas radhës nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në votim, marrin fletëvotimin i cili vulozet aty për aty dhe votojnë me votim të fshehtë.

Procesi i votimit në raundin e parë

Pas votimit nga këshilltarët që votuan, Komisioni fillon numërimin e votave, dhe pastaj i njëjti paraqet,

- ***Raport rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit, dhe i njëjti komunikon rezultatet e votimit.***

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, paraqiti raportin nga procesi i votimit në raundin e parë për zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit, theksoi, nga gjithsejtë 15 anëtar të Kuvendit që kanë marrë pjesë në votim, 13 vota janë për, 1 votë është kundër dhe 1 votë është abstenim / e pavlefshme. Bazuar në rregullat për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit konstatohet se në raundin e parë nuk plotësohen kushtet për tu zgjedhur, prandaj mund të shkojmë me raundin e dytë për zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit.

z.Naim Çunaku, Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, tani jemi në fazën ku mund të vazhdojmë me raundin e dytë për zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit, andaj nëse çdo gjë është në rregull mund të vazhdohet, por paraprakisht të verifikohet sërish kuorumi.

Konstatohet se prezent janë 30 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, dhe mund të vazhdohet me punë, përkatësisht me raundin e dytë të votimit, dhe njëkohësisht Kryesuesi i mbledhjes i sqaroj të pranishmit se fletëvotimet tani në këtë raund do të vulozen në pjesën e sipërme të fletës.

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, theksoi, sikurse në raundin e parë, edhe për raundin e dytë të votimit konstatohet se jemi në rregull për fillimin e procesit të votimit dhe mund të vazhdojmë sipas rregullave të njëjta.

Procesi i votimit në raundin e dytë

Pas votimit nga këshilltarët që votuan, Komisioni fillon numërimin e votave, dhe pastaj i njëjti paraqet,

- ***Raport rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit, dhe i njëjti komunikon rezultatet e votimit.***

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, theksoi, atëherë edhe në këtë raund të votimit prezent në sallë ishin 30 anëtarë/e të Kuvendit, prej tyre 15 anëtarë/e kanë marrë pjesë në procesin e votimit dhe rezultati i votimit është; 13 vota janë për, 1 votë është kundër, dhe 1 votë është e pavlefshme.

z.Naim Çunaku, Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, nga raporti i paraqitur prej Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesuese të Kuvendit të Komunës, kuptojmë që edhe në raundin e dytë nuk kemi të zgjedhur Kryesuesen e Kuvendit të Komunës, andaj mund të vazhdojmë me raundin e tretë.

z.Gazmend Islami, theksoi, propozoj të shkojmë në pauzë, për tu kthyer në vazhdimin e mbledhjes në ora 14;30

Njëzëri nga anëtarët e pranishëm në sallë u përkrah propozimi që të shkohet në pauzë deri në ora 14;30

Kuvendi shkon në pauzë në ora 11;10

Pas pauzës, mbledhja vazhdon duke filluar në ora 14;40, dhe sërish konstatohet se anëtari më i moshuar prezent në sallë është z.Naim Çunaku të cilit po ashtu i kalon e drejta për ta kryesuar mbledhjen.

z.Naim Çunaku, Kryesues i mbledhjes, e hapi vazhdimin e mbledhjes, theksoi, fillimisht kërkoj nga zyra për punë të Kuvendit të konstatoj kuorumin në mënyrë që të verifikohet se a ekzistojnë kushtet për punë.

Konstatohet se nga numri i përgjithshëm prej 35 sa janë anëtarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në sallë prezent janë 16 anëtarë/e të Kuvendit.

Kryesues i mbledhjes, vazhdoi, të nderuar të pranishëm, në raundin e tretë për zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit prezent jemi vetëm 16 anëtar/e të Kuvendit dhe nga kjo rezulton se për shkak të mos arritjes së kuoromit nuk mund të vazhdojmë tutje me punën e Kuvendit.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i respektuar Kryesues i mbledhjes, të respektuar anëtar të Kuvendit të Komunës, tani më po besoj se edhe qytetarët por edhe opinionin publik është duke e parë situatën dhe tani më publikisht po duket se kush janë të interesuar të bëjnë bllokimin e punës së konstituimit të tërësishëm të Kuvendit të Komunës.

Po shihet se Grupi i këshilltarëve të subjektit politik LDK, dy përfaqësues të AAK-së si dhe PDK janë duke bojkotuar procedurat e mëtejme për zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit.

Si do qoftë, në këto rrethana ne jemi të detyruar që këtë seancë të filluar sot ta shtyjmë për një moment tjetër më të përshtatshëm dhe po besoj që ndoshta do të ishte e rrugës që kjo seancë, e njëjta të vazhdoj punimet nesër nga ora 10;00 të mëngjesit në mënyrë që të bëjmë përpjekje për t'i shfrytëzuar komplet afatet Kushtetuese dhe ligjore të cilat parashihen për ta ezauruar këtë pikë të rendit të ditës për zgjedhjen e Kryesuesit/es së Kuvendit të Komunës.

Ne si institucion jemi shumë të interesuar që këtë proces ta zgjidhim sa më shpejt të jetë e mundur dhe sigurisht për këtë po e bëjmë punën tonë brenda mundësive dhe kapaciteteve që kemi me resurset tona që ta shtyjmë përpara këtë proces, mirëpo po shihet se nuk po varet nga ne vazhdimi i kësaj seance.

z.Naim Çunaku, Kryesues i mbledhjes, theksoi, nga kjo pas kësaj fjale të Kryetarit, nuk mbetet gjë tjetër vetëm që të konstatojmë që seanca për zgjedhjen e Kryesuesit/es të Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa të ndërpritet dhe e njëjta të vazhdoj nesër më 30 dhjetor 2021 nga ora 10;00, për çka kërkoj nga zyrtari për punë të Kuvendit që t'iu dërgoj njoftimin përkatës në adresat elektronike të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, me theks atyre që për momentin nuk janë të pranishëm në sallë.

Me kaq e konstatoj të ndërprerë seancën e filluar sot, për të vazhduar nesër në ora 10;00, dhe po citoj Rregulloren e Punës së Kuvendit, neni 32 pika 3 ku thuhet; *në rast se gjatë mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se nuk ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje e ndërprerë mbledhjen dhe e cakton kohën e fillimit të vazhdimit të mbledhjes*, që do të thotë se ne u dakorduar që seanca të vazhdoj punën nesër në ora 10;00.

Konstatohet se pas pauzës (13:10 – 14:40), në mungesë të kuorunit për vazhdimin e mbledhjes, mbledhja ndërpritet dhe njëkohësisht caktohet data dhe koha e vazhimit të mbledhjes në pikën / procesin ku ka mbet dhe njëkohësisht kërkohet nga zyra për punë të Kuvendit t'iu dërgohet njoftimi të gjithë anëtarëve të Kuvendit që mbledhja është ndërprerë dhe është caktuar të vazhdoj më 30 dhjetor 2021 në ora 10:00.

Mbledhja ndërpritet në ora 14:45

Vazhdimi i mbledhjes më 30 dhjetor 2021

Mbledhja filloi në orën 10:50 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, në ndërtesën e re të Komunës së Podujevës.

Mbledhjen e kryesoi z.Hilmi Hoxha, anëtar më i moshuar me radhë i Kuvendit të Komunës.

(pasi që z.Fahri Hasani si anëtari më i moshuar i Kuvendit të Komunës po ashtu nuk pranoi ta kryesoi mbledhjen, me arsyetimin se nuk është në gjendje të mirë shëndetësore për një gjë të tillë)

Në fillimin e vazhimit të mbledhjes të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç z.Bashkim Sylja, znj.Endritë Murati dhe znj.Mimoza Abdullahu të cilët aktualisht nuk ishin prezent.

Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale dhe më gjerë, përfaqësues të KFOR, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, e hapi vazhdimin e mbledhjes së datës 29 dhjetor 2021 të ndërprerë një ditë më parë për shkak të kuorunit të pamjaftueshëm, për të vazhduar aty ku ka mbet, sot më 30 dhjetor 2021 ashtu siç është caktuar dhe siç janë njoftuar anëtarët e Kuvendit.

Para se të fillojmë konstatohet se në bazë të nënshkrimeve në listën e pjesëmarrjes dhe verifikimit nga ana e zyrës për punë të Kuvendit, prezent në sallë momentalisht janë 32 anëtar/e të Kuvendit, kurse mungojnë 3.

Si proces kemi mbet në pikën e rendit të ditës që është zgjedhja e Kryesuesit/es të Kuvendit të Komunës, përkatësisht kemi një kandidate të propozuar dhe janë zhvilluar dy raundet e para për zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit por që nuk ka marr numrin e mjaftueshëm për tu zgjedhur Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kurse tani si proces kemi mbet kemi mbete në raundin e tretë të votimit, andaj kërkoj nga Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit të përgatitet për raundin e tretë të votimit. Komisioni është i ngritur në këtë përbërje; z.Bahri Selimi, z.Arbnor Fazliu dhe z.Gazmend Islami, prandaj para se të fillohet me punë, fjalën e ka kërkuar kandidatja e propozuar për Kryesuese të Kuvendit znj.Adelinë Stublla.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, meqë po shihet se në këtë mënyrë nuk mund të ecet tutje, atëherë unë si kandidate për Kryesuese të Kuvendit të Komunës, tërhiqem nga gara në mënyrë që të zhbllokohet procesi për zgjedhjen e Kryesuesit/es të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Atëherë ju falënderoj për dy raundet paraprake të gjithë ata që më votuan dhe ata që nuk më votuan, kështu që mund të vazhdohet tutje në mënyrë që të zhbllokohet procesi dhe të ecet tutje.

z.Gazmend Islami, theksoi, kam një lutje dhe kërkesë për të gjitha subjektet politike të përfaqësuar në këtë Kuvend. Është në nderin tonë që mos t'i maltretojmë Llapjanët të cilët kanë bërë të pamundurën që të zgjedhin më të mirët që kanë menduar për anëtar të Kuvendit të komunës së Podujevës për këtë mandat 4 vjeçar për të përfaqësuar interesat e tyre.

Është e turpshme dhe aspak njerëzore nëse bëjmë kalkulime të tilla të cilat zbehin jo vetëm integritetin ton por edhe të këtij Kuvendi, për çka unë personalisht po ndihem i turpëruar edhe pse jam për herë të parë pjesë e këtij Kuvendit dhe nëse vazhdon kështu unë do të tërhiqem krejt sepse nuk po shoh që ka moral këtu dhe është pa pikë morali. Unë nuk e di se si ai që ka marr 500-600-700 vota mund ta ndjej vetën para qytetarëve Llapjan duke na parë ata duke bërë “humor” ne në Kuvend. Seanca shtyhet për të vazhduar në ora 10:00 kurse ne vijmë në ora 11:00, për çka ndodh kjo, prandaj mund të konsideroj se nuk kemi integritet tonë e lëre më ta përfaqësojmë dikë, andaj ju bëjë thirrje t’i ulni gjakrat sepse nuk jemi hasëm mes vete por jemi të gjithë Shqiptar dhe njihemi mes vete, jemi vëllezër dhe motra, kemi luftuar ta kemi një Kuvend të tillë ku shprehet mendimi i lirë, mund të kemi bindje dhe mendime tjera politike por assesi hasmëri mes vete, prandaj e përsërisë që të ulen gjakrat, të kalkulohet mirë situata, të zgjedhet Kryesuesi/ja e Kuvendit dhe të ecim përpara, kush të dojë të jetë pjesë e pushtetit i ka dyert e hapura, kush do që të jetë në opozitë le të mbetet, mirëpo proceset duhet të shtyhen përpara. Pra kjo ishte një thirrje vëllazërore për të gjithë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar këshilltarë të tjerë për të marrë fjalën, atëherë konsideroj se është mirë të shikojmë për 1 orë në pauzë, pra në ora 12:00 të vazhdoj mbledhja.

Kuvendi shkon në pauzë për 1 orë:

Pas pauzës, mbledhja vazhdon duke filluar në ora 12:30

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, theksoi, mund të vazhdojmë me procesin ku kemi mbet, por paraprakisht fjalën e ka kërkuar Kryetari i Komunës.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, më lejoni që në emrin tim personal por edhe në emrin tuaj si Kuvend, anëtarit të Kuvendit z.Bashkim Syla t’i shprehë ngushëllime për vdekjen e prindit të tij.

Kryesues i mbledhjes, pra vazhdojmë me seancën, konstatohet se prezent në sallë janë të gjithë anëtarët e Kuvendit (35).

Pra jemi në pikën 2 të rendit të ditës që është zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit.

Me rregullativën ligjore parashihet që procesi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit përsëritet.

Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit është ngritur, përbëhet nga anëtarët e Kuvendit z.Bahri Selimi, z.Arbnor Fazliu dhe z.Gazmend Islami, andaj a jeni që ky komision të vazhdoj me punë sipas procesit.

Me 20 vota PËR, 1 votë KUNDËR, asnjë votë TË PËRMBAJTUR (të tjerët nuk morën pjesë në votim), Kryesuesi konstaton se mbështet që Komisioni i ngritur për mbarëvajtjen e procesit të votimit në përbërje z.Bahri Selimi, z.Arbnor Fazliu dhe z.Gazmend Islami, të vazhdoj me punë.

Kryesues i mbledhjes, theksoi, tani vazhdojmë me punë dhe jemi në fazën e propozimit të kandidatëve për Kryesues të Kuvendit. Urdhëroni fjalën e ka kërkuar znj.Mimoza Abdullahu.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, ne për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Podujevës propozojmë z.Hilmi Hoxhën, i cili është profesor për 30 vite në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” në Podujevë, dhe është i zgjedhur për herë të tretë anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Kryesues i mbledhjes, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, konstatohet se ka një kandidat të propozuar për Kryesues të Kuvendit dhe mund të vazhdohet me punë nga ana e

Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, por duhet pritur rreth 5 minuta deri sa të sjellën materialet e votimit

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, theksoi, si komision vlerësojmë se janë plotësuar kushtet për vazhdimin apo përsëritjen e procesit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, materialet janë në rregull, andaj mund të fillojmë me punë sipas procedurave përkatëse.

Nga Komisioni në fjalë konstatohet se për këtë raund të votimit, (votimit i parë pas përsëritjes së procesit), lista e anëtarëve të Kuvendit është në rregull, fletëvotime po ashtu janë 35 dhe të gjitha të rregullta, vula po ashtu është në dispozicion për vulosjen e fletëvotimeve të gjithë anëtarëve të cilët nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në procesin e votimit ku me ç'rast edhe marrin fletëvotimin. Pra mund të fillojmë duke i thirrur emër për emër me radhë sipas listës përkatëse.

Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit (në përbërje z.Bahri Selimi, z.Arbnor Fazliu dhe z.Gazmend Islami) fillon punën duke verifikuar fletëvotimet fillimisht, listën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pastaj duke thirrur emër për emër sipas radhës gjithë anëtarët e Kuvendit të cilët sipas radhës nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në votim, marrin fletëvotimin i cili vulolet aty për aty dhe votojnë me votim të fshehtë.

Procesi i votimit në raundin e parë – pas procesit të përsëritur

Pas votimit nga këshilltarët që votuan, Komisioni fillon numërimin e votave dhe atë duke bërë transparente para të pranishmëve çdo fletëvotim, dhe pastaj i njëjti paraqet,

- **Raport rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit, dhe i njëjti komunikon rezultatet e votimit.**

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, paraqiti raportin nga procesi i votimit në raundin e parë pas procesit të përsëritur për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, nga gjithsejtë 35 anëtarë/e sa janë prezent në sallë, 19 anëtar/e të Kuvendit kanë marrë pjesë në votim, 17 vota janë PËR, dhe 2 vota janë të pavlefshme.

Kryesuesi i mbledhjes, pas paraqitjes së raportit nga ana e Komisionit, konstatohet se duhet të vazhdohet me raundin e dytë të votimit – pas përsëritjes së procesit, pasi që kandidati për Kryesues të Kuvendit të Komunës nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për Kryesues të Kuvendit. Prandaj kërkohet nga Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit që të vazhdoj me punë.

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, theksoi, po ashtu sikurse në procesin paraprak, si komision vlerësojmë se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e procesit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, me raundin e dytë pas përsëritjes së procesit, materialet janë në rregull, andaj mund të fillojmë me punë sipas procedurave përkatëse.

Nga Komisioni në fjalë konstatohet se për këtë raund të votimit, (votimit i dytë pas përsëritjes së procesit), lista e anëtarëve të Kuvendit është në rregull, fletëvotime po ashtu janë 35 dhe të gjitha të rregullta, vula po ashtu është në dispozicion për vulosjen e fletëvotimeve të gjithë anëtarëve të cilët nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në procesin e votimit ku me ç'rast edhe marrin fletëvotimin. Pra mund të fillojmë duke i thirrur emër për emër me radhë sipas listës përkatëse.

Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit (në përbërje z.Bahri Selimi, z.Arbnor Fazliu dhe z.Gazmend Islami) fillon punën duke verifikuar fletëvotimet fillimisht, listën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pastaj duke thirrur emër për emër sipas radhës gjithë anëtarët e Kuvendit të cilët sipas radhës nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në votim, marrin fletëvotimin i cili vulozet aty për aty dhe votojnë me votim të fshehtë.

Procesi i votimit në raundin e dytë – pas procesit të përsëritur

Pas votimit nga këshilltarët që votuan, Komisioni fillon numërimin e votave dhe atë duke bërë transparente para të pranishmëve çdo fletëvotim, dhe pastaj i njëjti paraqet,

- **Raport rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit, dhe i njëjti komunikon rezultatet e votimit.**

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, paraqiti raportin nga procesi i votimit në raundin e dytë pas procesit të përsëritur për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, nga gjithsejtë 35 anëtarë/e sa janë prezent në sallë, 19 anëtar/e të Kuvendit kanë marrë pjesë në votim, 17 vota janë PËR, dhe 2 vota janë të pavlefshme.

Kryesuesi i mbledhjes, pas paraqitjes së raportit nga komisioni në fjalë, konstatohet se duhet të vazhdohet me raundin e tretë të votimit – pas përsëritjes së procesit zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, pasi që sërish kandidati në fjalë nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për tu zgjedhur Kryesues i Kuvendit.

Prandaj kërkohet nga Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit që të vazhdoj me punë.

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, theksoi, gjithashtu sikurse në dy proceset paraprake, si komision vlerësojmë se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e procesit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, me raundin e tretë të votimit - pas përsëritjes së procesit, materialet janë në rregull, andaj mund të fillojmë me punë sipas procedurave përkatëse.

Nga Komisioni në fjalë konstatohet se për këtë raund të votimit, (votimit i tretë pas përsëritjes së procesit), lista e anëtarëve të Kuvendit është në rregull, fletëvotime po ashtu janë 35 dhe të gjitha të rregullta, vula po ashtu është në dispozicion për vulosjen e fletëvotimeve të gjithë anëtarëve të cilët nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në procesin e votimit ku me ç'rast edhe marrin fletëvotimin. Pra mund të fillojmë duke i thirrur emër për emër me radhë sipas listës përkatëse.

Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit (në përbërje z.Bahri Selimi, z.Arbnor Fazliu dhe z.Gazmend Islami) fillon punën duke verifikuar fletëvotimet fillimisht, listën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pastaj duke thirrur emër për emër sipas radhës gjithë anëtarët e Kuvendit të cilët sipas radhës nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në votim, marrin fletëvotimin i cili vulozet aty për aty dhe votojnë me votim të fshehtë.

Procesi i votimit në raundin e tretë – pas procesit të përsëritur

Pas votimit nga këshilltarët që votuan, Komisioni fillon numërimin e votave dhe atë duke bërë transparente para të pranishmëve çdo fletëvotim, dhe pastaj i njëjti paraqet,

- **Raport rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit, dhe i njëjti komunikon rezultatet e votimit.**

z.Bahri Selimi, në emër të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, paraqiti raportin nga procesi i votimit në raundin e tretë pas procesit të përsëritur për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, konstatojmë se nga gjithsejtë 35 anëtarë/e sa janë prezent në sallë, 19 anëtar/e të Kuvendit kanë marrë pjesë në votim, 19 vota janë PËR, asnjë KUNDËR dhe asnjë e pavlefshme.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i mbledhjes, theksoi, duke u bazuar në raportin e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesues të Kuvendit të Komunës, konstatojmë se Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës zgjedhem unë Hilmi Hoxha, dhe me këtë rast falënderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit (ata që më kanë votuar dhe ata që nuk më kanë votuar), pra për të gjithë do të jem Kryesues i Kuvendit të Komunës për 4 vitet e ardhshme.

Fjalë rasti e Kryesuesit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, pas zgjedhjes në këtë funksion, e paraqiti një fjalë rasti, theksoi, i nderuar Kryetar i Komunës, anëtar dhe anëtare të Kuvendit, monitorues nga Organizata të ndryshme, media dhe qytetarë të nderuar të Komunës së Podujevës, sot anëtarët e Kuvendit ma besuan këtë detyrë, për mua nuk është privilegj, është paksa krenari dhe shumë përgjegjësi, krenaria zbehet, përgjegjësia rritet kur e kujtojmë se këtu jemi për t'iu shërbyer qytetarëve dhe jemi të zgjedhurit e tyre, të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Podujevës ju falënderoj për zemërsisht për çdo votë të Juaj dhe besimin që më dhuruat mua.

U zgjedha nga Ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, por unë jam njëri prej Juve, andaj së bashku do të vendosim dhe do të punojmë për të mirën e qytetarëve të Komunës së Podujevës, bashkë do t'iu dalim në ballë sfidave që na presin, bashkë do të krijojmë hapësirë për zhvillimin e Komunës tonë sepse prandaj jemi këtu që t'iu shërbejmë qytetarëve dhe të rrugëtojmë me ata për një jetë më të mirë dhe të qetë.

Për fund, të gjithë anëtarëve të zgjedhur të këtij Kuvendi dhe njëkohësisht Kryetarit të Komunës, i'u uroj një mandat të frytshëm, të mirë dhe produktiv në shërbim të banorëve të Komunës së Podujevës, dhe qofshi faqebardhë në këtë rrugëtim, ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit, fjalën i'a jep Kryetarit të Komunës.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Kuvendit, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit dhe ju anëtar të Kuvendit të Komunës, më lejoni se në emrin tim Kryesuesit të sapo zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Podujevës t'i uroj punë të mbarë dhe suksese bashkërisht.

Unë besoj se sot pas këtij raundi të votimit dhe pas zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit kanë fituar qytetarët e Komunës së Podujevës dhe kanë fituar qytetarët e Llapit për arsye se të gjithë jemi në dijeni se këtë Kuvend por njëkohësisht edhe neve si qeverisje lokale na presin një varg i punëve të cilat kanë mbet peng i mos votimeve nga përbërja e kaluar e Kuvendit të Komunës.

Jeni në dijeni se është paksa problematike çështja e buxhetit të Komunës e cila vlerësoj se tani duhet të procedohet shumë shpejt për shqyrtim dhe miratim në Kuvend sepse jemi ndoshta prej të paktave Komuna që nuk e kemi të miratuar buxhetin për çka arsyet tashmë qytetarët e Komunës së

Podujevës i dinë, pastaj e kemi Hartën Zonale e cila është jetike për Komunën tonë e cila është në proces dhe shpresojmë se shumë shpejt do të përmbyllet, por sigurisht na presin edhe një varg punësh dhe problemeve të cilat bashkërisht do t'i zgjedhim.

I dëshiroj punë të mbarë këtij Kuvendi, pozitë – opozitë sepse fundja të gjithë jemi në shërbim të qytetarëve dhe nga këtu dhe prej sot e tutje edhe njëherë e shtrijmë dorën e bashkëpunimit dhe do të doja çdo vendim që del nga ky Kuvend të jetë vendim me shumicë absolute të votave për arsye se ne të gjithë këtu jemi në shërbim të qytetarëve.

Nga ana jonë si pozitë, do të bëjmë çmos që proceset që lidhen me interesin e qytetarëve t'i shtyjmë dhe ecim përpara për arsye se kemi marrë besimin e tyre.

Edhe njëherë urime për Kryesuesin dhe gjithë anëtarët e Kuvendit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe vazhdojmë me pikën e radhës.

3. Themelimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa

- *Propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa*

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra në këtë pikë kemi të bëjmë me themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF, Komitet i cili formohet nga të gjitha grupimet e subjekteve politike, mirëpo e shohë të arsyeshme të shkojmë në pauzë të shkurtër dhe brenda kësaj pauze të kemi një takim me shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit apo përfaqësuesit e subjekteve politike në mënyrë që para se të fillojmë me këtë pikë të rendit të ditës të diskutojmë më gjerësisht mes vete qoftë për emra qoftë për strukturë të këtij Komiteti. Pra pauza zgjatë rreth 10 minuta dhe takimi të mbahet në sallën 52 në katin e tretë.

Pas një pauze prej rreth 10 minutave,

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, pra kishim një takim unë si Kryesues i Kuvendit me shefat dhe përfaqësuesit e Grupeve dhe subjekteve politike, mirëpo nuk gjetëm një gjuhë të përbashkët që të propozohen anëtarët për KPF, kështu që meqë nuk i kemi emrat e anëtarëve nga të gjitha subjektet për t'i propozuar për anëtar në KPF nuk mund ta formojmë përbërjen e tij, prandaj në këtë situatë unë propozoj që kjo seancë të ndërpritet dhe e njëjta të vazhdoj nesër në ora 10:00 në mënyrë që secili subjekt politik të vie me propozimet e emrave dhe mbiemrave për anëtar të KPF-së, propozim ky i cili vie ngase nuk po shoh rrugë tjetër, mirëpo nëse ndokush ka ndonjë propozim tjetër urdhëroni.

z.Avni Fetahu, theksoi, nga përvoja jemi në dijeni se emrat mund të ndërrohen, andaj nëse është e mundshme do të ishte mirë të propozohen emrat sot nga të gjitha subjektet politike, dhe pasta nesër nëse dëshiron ta ndërroj ndonjë emër atëherë mund ta bëjë një gjë të tillë, pra nuk paraqet kurrfarë pengese kjo.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë që e potencoj parafolësi mendoj se nëse sot jepen emrat dhe formohet përbërja e KPF-së, atëherë nesër nuk kemi nevojë të mbajmë mbledhje fare.

z.Bahri Selimi, theksoi, më duket goxha maltretim që të mblidhemi edhe njëherë nesër për këtë çështje duke qenë se edhe ashtu kjo mbledhje ka filluar një ditë më parë dhe u ndërpre disa herë, mirëpo për këtë do të ishte mirë të na sqaroj zyra ligjore se a mund të mbahet seancë e Kuvendit pa u thirr mbledhje e KPF-së nëse nuk është i formuar në total. Atëherë nëse po ne mund të mbajmë

seancë të Kuvendit dhe të mos insistojmë që patjetër ta formojmë KPF-në nesër me vazhdimin e seancës, përndryshe po e formojmë sot dhe po e përmbyllim këtë proces sepse ka shumë njerëz dhe anëtar të Kuvendit që kanë humbur bukur shumë kohë për këto dy ditë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ata që kanë qenë anëtar të Kuvendit edhe më herët, janë në dijeni se mbledhjes së Kuvendit i paraprinë mbledhja e KPF-së, kështu që mendoj se ne patjetër duhet të mbajmë / vazhdojmë këtë seancë në mënyrë që ta kemi të formuar përbërjen e KPF-së.

z.Bahri Selimi, theksoi, atëherë ta formojmë sot përbërjen e KPF-së meqë ka mundësi pastaj në të ardhmen të ndryshohen emrat, ose të shkojmë në një pauzë dhe të ketë konsultime nga subjektet politike që nuk i kanë caktuar emrat në mënyrë që sërish të vazhdojmë me këtë seancë dhe ta formojmë përbërjen e KPF-së. Pra konsideroj se kjo është më mirë sesa ta humbim edhe një ditë duke u mbledh sërish për t'i prezantuar emrat e anëtarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në takimin konsultativ që kishim ne për formulën dhe strukturën e përbërjes së KPF-së u përcaktuam. LDK dhe LVV me nga 3 anëtar/e, PDK 1 anëtar/e, dhe AAK 1 anëtar/e si dhe unë si Kryesues i Kuvendit me automatizëm sipas funksionit/pozitës, kështu që siç po vërehet Grupi i LDK-ës nuk i ka emrat ende, në anën tjetër zyra ligjore më sqaruan se KPF veç është e themeluar me Ligj dhe Statut dhe kuvendet komunale vetëm duhet të përcaktohen për përbërjen dhe të vendosin për emrat e propozuar, natyrisht duke mos harruar edhe përfaqësimin gjinor, por nëse pa i vendosur emrat formojmë përbërjen e një komiteti atëherë Ministra përkatëse mund të mos na e konfirmoj ligjshmërinë e vendimit sepse esenca e formimit është caktimi i emrave të anëtarëve.

z.Valon Demolli, theksoi, mendoj se është mirë të shkojmë në pauzë për rreth 1 orë ngase na duhen disa konsultime mes anëtarëve të Grupit, pastaj pas 1 ore vazhdojmë seancën dhe i japim emrat edhe ne si Grup i LDK-së dhe sigurisht se do ta formojmë përbërjen e KPF-së.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë edhe unë e përkrahë kërkesën e parafolësit që të shkojmë në pauzë për 1 orë në mënyrë që me vazhdimin e seancës të jepen propozimet nga të gjitha subjektet politike dhe ta formojmë përbërjen e KPF-së.

Meqë nuk pati kundërshtime nga ndonjë prej anëtarëve apo subjekteve të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit e ndërprente seancën dhe cakton vazhdimin e saj në ora 15:00.

Kuvendi shkon në pauzë në ora 13:55

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 15:15, konstatohet kuorumi ku aktualisht prezent ishin 29 anëtar/e të Kuvendit të Komunës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, pas pauzës prej rreth 1 orë, e hapi vazhdimin e mbledhjes, theksoi, edhe njëherë ju njoftoj se në bazë të konsultimeve me përfaqësuesit e Grupeve të subjekteve politike bashkërisht u pajtuam për formulën e strukturës së përbërjes së KPF-së, kështu që erdhëm në përfundim se LDK dhe LVV kanë nga 3 anëtar/e, PDK 1 anëtar/e dhe AAK një anëtar/e, andaj nëse ndokush ka ndonjë vërejtje, propozim apo sugjerim rreth kësaj urdhëroni, nëse jo ftoj përfaqësuesit e subjekteve politike që të japin propozimet e tyre për anëtar/e në KPF, por paraprakisht a jeni që të vazhdohet me formulën e strukturës së përbërjes së KPF-së.

Njëzëri nga të pranishmit u mbështet që Komitetit për Politikë dhe Financa të përbëhet prej 9 anëtarëve, dhe atë; Kryesuesi i Kuvendit me automatizëm sipas funksionit që mban, 3 anëtar/e LDK, pastaj po ashtu 3 anëtar/e LVV, 1 anëtar/e PDK dhe 1 anëtar/e AAK, me sugjerim që të respektohet kuota gjinore.

z.Valon Demolli, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së, për anëtar/e në KPF propozohen; z.Naim Çunaku, z.Qëndrim Softolli dhe znj.Arsnisa Sylejmani.

Kryesuesi i Kuvendit, sqaron parafolësin se duhet të respektohet kuota gjinore me rastin e dhënies së propozimeve, pra nga 9 anëtar të KPF-së duhet të jenë të paktën 4 femra ose anasjelltas 4 meshkuj.

z.Valon Demolli, theksoi, konsideroj se jemi në rregull i nderuar Kryesues, neve si Grup i LDK-së na takojnë 3 anëtar/e dhe i japëm propozimet tona, 2 meshkuj dhe 1 femër, dhe tani në vazhdim mbetet të nxjerrët përqindja prej 50% për kuotën gjinore.

z.Bahri Selimi, theksoi, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LVV-së, për anëtar në KPF propozohen; znj.Adelinë Stublla, z.Florent Hasani dhe z.Artrit Mulliqi.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të PDK-së propozohet z.Bashkim Sylja.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, ne si AAK për anëtar në KPF propozojmë z.Burim Hasanin.

Kryesuesi i Kuvendit, ftoj nëse ka të interesuar për të marrë fjalën.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të kuotës gjinore propozoj znj.Mrika Thaçi për anëtare në përbërjen e KPF-së.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë tani kemi dy propozime të emrave nga subjekti i njëjtë politikë që është AAK, mendoj se këto dy propozime duhet të hedhen në votim veç e veç.

Përndryshe këtë përbërje e cila u propozua, konsideroj se nuk mund ta hedhim në votim për shkak se me vetëdije bëjmë lëshim duke mos respektuar kuotën gjinore, kështu që është mirë të gjejmë kompromis mes vete në mënyrë që t'ju japim hapësirë femrave dhe ta formojmë KPF-në ashtu siç parashihet me ligj.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, secili subjekt politik ka propozuar nga një femër, me përjashtim të subjektit PDK, kështu që mendoj se është mirë që edhe Grupi i PDK-së ta propozoj një femër.

z.Fatri Zhitija, theksoi, kemi dy propozime nga radhët e subjektit politik AAK, një mashkull dhe një femër, kështu që mendoj se do të ishte mirë që znj.Mrika Thaçi të jetë pjesë e përbërjes së KPF në mënyrë që të përmbushet kuota gjinore.

z.Pajtim Balaj, theksoi, dy subjektet me numrin më të madh të anëtarëve në Kuvend veç propozuan femra dhe tani nuk munden që këto dy subjekte të respektojnë kuotën gjinore edhe për subjektet tjera, kështu që mendoj se në këtë rast i takon subjekteve PDK dhe AAK që ta mundësojnë përfaqësimin gjinor në përbërjen e KPF-së.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, përderisa ne si PDK kemi vetëm një anëtar në KPF kemi propozuar z.Bashkim Sylën, kurse ju (LDK dhe LVV) si subjekte me numër më të madh keni më shumë mundësi të zgjidhjes sepse keni nga 3 anëtar në KPF.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, edhe ne si AAK përfaqësohemi në këtë Kuvend me 2 meshkuj dhe 1 femër, kështu që nuk paraqet ndonjë diskriminim në këtë rast që kemi propozuar 1 mashkull për anëtar në KPF.

z.Avni Fetahu, theksoi, mendoj se është e nevojshme të kemi një pauzë të shkurtër - 5 minuta, në mënyrë që PDK të ketë konsultë mes vete, ndoshta edhe me të propozuarin e tyre z.Bashkim Sylja me qëllim që ta bëjë një tolerim eventual, dhe pastaj të hedhen në votim dy propozimet e dhëna në mënyrë që të bëhet zgjidhje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim, ne shumë shpejt duhet të formojmë edhe përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe me këtë rast subjektet politike do të kenë mundësi që edhe në atë Komitet të propozojnë anëtarët e tyre, kështu që nëse ndokush mbetet pa u bërë pjesë e KPF-së ka mundësi që të jetë pjesë e Komitetit për Komunitete, kështu që mund të kemi një kompromis këtu.

z.Fatri Zhitija, theksoi, nëse nuk japin zgjidhja subjektet politike atëherë do të ishte mirë të vendosim si Kuvend përmes votimit.

z.Pajtim Balaj, theksoi, kompromisi për të cilin foli Kryesuesi i Kuvendit, mendoj se kompromis nuk mund të bëhet mbi kurrizin e kuotës gjinore, por është normë që duhet të zbatohet, andaj kompromis në këtë rast duhet të bëjnë meshkujt.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të plotësimit të kuotës gjinore unë si i propozuar për anëtar në përbërjen e KPF-së tërhiqem nga cilësia e të propozuarit me qëllim që të hap rrugë zgjidhjes së kësaj çështje.

z.Bahri Selimi, theksoi, meqë në këtë situatë duhet të sakrifikoj dikush dhe këtë e bëri kolegu parafolës z.Artrit Mulliqi në emër të hapjes së mundësisë për zgjidhjen e kësaj çështje, atëherë në vend të tij nga radhët e Grupit të LVV-së e propozojmë znj.Sebastina Vokri.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani kemi propozimet për formimin e përbërjes së KPF-së, emrat e propozuar janë: Naim Çunaku, Qëndrim Softolli, Arsnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Sylja dhe Mrika Thaçi e cila mbetet për shkak të respektimit të kuotës gjinore, si dhe unë sipas funksionit në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, ne si AAK e patëm propozim z.Burim Hasanin, por nëse dëshironi të na diskriminoni atëherë në rregull është, mirëpo fundja të hedhen në votim propozimet e bëra.

z.Pajtim Balaj, theksoi, ne mund të votojmë por sërish mund të përballemi me këtë situatë ku mund të mbeten vetëm 3 femra në përbërjen e KPF-së e që sërish nuk plotësohet kuota gjinore.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne si Kuvend mund të vendosim, mirëpo kemi Ministrinë përkatëse e cila mund të mos e pranoj një gjë të tillë. Kuota gjinore dihet se respektohet në çdo institucion andaj edhe në këtë Kuvend duhet të respektohet, prandaj nuk e di çfarë ka të keqe që të jetë znj.Mrika Thaçi prej subjektit AAK.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, edhe njëherë e përsërisë që ne si AAK patëm propozim z.Burim Hasanin, ndërsa nëse ju mendoni se vendosni për neve atëherë urdhëroni vendosni.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim parafolësit, Kuvendi vendos jo ne.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk do të doja të lëshohemi në personalitete, ky apo ai. E dimë që përmbushja e kriterit gjinor nuk është vullnet por është ligj dhe në bazë të asaj nëse jemi ndesh me ligjin nuk funksionon pastaj, prandaj nuk do të doja të zhvillohen debate për emra të personave por të vëhet në votim dhe ai ose ajo që merr votat e mjaftueshme kalon dhe bëhet pjesë e përbërjes së KPF-së. E them këtë sepse të dy të propozuarit (znj.Mrika Thaçi dhe z.Burim Hasanin) i kemi kolegë dhe nuk është mirë të hyjmë në debate të tilla, prandaj Kuvendi është ai që vendos dhe mirë që po e dimë si Kuvend se çfarë kërkohet andaj edhe është në dorën e Kuvendit të vendosë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, sa për sqarim rreth asaj që parafolësi e potencoj se Kuvendi vendos, mirëpo nëse hedhet në votim dhe kalon një përbërje duke mos u respektuar përfaqësimi i nevojshëm gjinor atëherë me vetëdije po merret një vendim i cili sigurisht se do të kthehet jo në harmoni me ligjin.

z.Naim Çunaku, theksoi, nëse veç jemi në këtë situatë atëherë kemi vetëm dy zgjidhje, nuk kemi nevojë të hedhim në votim propozimet e paligjshme por i hedhim ato të ligjshmet, mirëpo nëse vendoset të hedhen në votim atëherë duhet të vendosim paraprakisht vetëm emrat e dy të propozuarve në fjalë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pas diskutimeve si përfundim rrjedh propozimi që të hedhen në votim veç e veç emrat e të propozuarve të AAK-së dhe ai ose ajo që merr vota më shumë edhe bëhet pjesë e propozimeve për formimin e përbërjes së KPF-së.

Kush jeni që z.Burim Hasani nga AAK të jetë pjesë e përbërjes së KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtarë/e prezent, 11 janë PËR, 16 vota janë KUNDËR dhe asnjë votë e PËRMBAJTUR, që z.Burim Hasani të jetë pjesë e propozimeve për anëtar në përbërjen e KPF-së.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani e hedhim në votim anëtarin tjetër znj.Mrika Thaçi që të jetë pjesë e propozimeve në përbërjen e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtarë/e prezent, 26 vota janë PËR, 1 votë KUNDËR dhe asnjë votë e PËRMBAJTUR, që znj.Mrika Thaçi të jetë pjesë e propozimeve për anëtar në përbërjen e KPF-së.

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra konstatohet se znj.Mrika Thaçi merr më shumë vota që të jetë pjesë e propozimeve të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Tani kemi përbërjen e plotë të propozimeve për anëtar/e të KPF-së, dhe atë; Naim Çunaku, Qëndrim Softolli, Arsnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Sylja dhe Mrika Thaçi, si dhe unë Hilmi Hoxha me automatizëm sipas pozitës së Kryesuesit të Kuvendit, andaj e hedh në votim themelimin e përbërjes së KPF-së sipas propozimeve të cekura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtarë/e prezent, me 26 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet themelimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- 1.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit (sipas pozitës),*
- 2.Naim Çunaku, nga subjekti politik LDK,*
- 3.Qëndrim Softolli, nga subjekti politik LDK,*
- 4.Arsnisa Sylejmani, nga subjekti politik LDK,*
- 5.Adelinë Stublla, nga subjekti politik LVV,*
- 6.Florent Hasani, nga subjekti politik LVV,*
- 7.Sebastina Vokri, nga subjekti politik LVV,*
- 8.Bashkim Sylja, nga subjekti politik PDK,*
- 9.Mrika Thaçi, nga subjekti politik AAK*

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:40

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0111870/21

Podujevë,

30 dhjetor 2021

Kryesues i një pjese të mbledhjes
(Në cilësinë e anëtarit më të moshuar prezent)

Naim Çunaku_____

Kryesuesi i mbledhjes
(Në cilësinë e anëtarit më të moshuar)
dhe i zgjedhur Kryesues i Kuvendit

Hilmi Hoxha_____